



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykesues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 qershor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit
mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Shtabit të
Përgjithshëm dhe Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (QPK)**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORKU PROCEDURAL

1. Më 21 maj 2025, Trupi Gjykues lëshoi Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës ("Vendimi i Kundërshtuar").¹
2. Më 28 maj 2025, ekipet e Mbrojtjes të katër të akuzuarve (bashkërisht, "Mbrojtja") dorëzuan kërkesë për leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").²
3. Më 10 qershor 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi përgjigjen ndaj Kërkesës së Mbrojtjes ("Përgjigjja").³
4. Më 16 qershor 2025, Mbrojtja dorëzoi kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së ZPS-së ("Kundërpërgjigjja").⁴

II. PARASHTRIME

5. Mbrojtja kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar lidhur me tri pikat ("Pikat") në vijim:

¹ F03191, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Shtabit të Përgjithshëm dhe Qeverisë së Përkohshme të Kosovës*, 21 maj 2025, konfidencial. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 12 qershor 2025, F03191/COR.

² F03210, Mbrojtja, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Shtabit të Përgjithshëm dhe QPK-së*, 28 maj 2025, konfidenciale.

³ F03244, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Apelim F03210*, 28 qershor 2024, publike.

⁴ F03269, Mbrojtja, *Kundërpërgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes Leje për Apelim F03210*, 16 qershor 2025, konfidenciale.

- (i) Nëse në Vendimin e Kundërshtuar është bërë gabim faktik ose juridik kur janë konsideruar vetëm tregues që mbështesin autenticitetin dhe jo tregues që cenojnë autenticitetin ("pika e parë");⁵
- (ii) Nëse Trupi Gjykes bëri gabim faktik ose juridik kur konstatoi se Mbrojtja nuk është dëmtuar nga pranimi si prova të dokumenteve të SHP-së/QPK-së nga ZPS-ja *në fund të paraqitjes së provave prej saj*, gjë që e pengoi Mbrojtjen t'ua paraqiste ato dëshmitarëve të Prokurorisë për verifikimin e autenticitetit dhe vlerës provuese të tyre gjatë paraqitjes së provave nga ZPS-ja ("pika e dytë");⁶ dhe
- (iii) Nëse Trupi Gjykes bëri gabim faktik ose juridik kur konstatoi se – për secilin prej dokumenteve – efekti dëmtues nuk zhbëhet nga vlera provuese, sepse Mbrojtja do të jetë në gjendje të kundërshtojë dokumentet përmes paraqitjes së provave në një fazë të mëvonshme të gjykitimit ("pika e tretë").⁷

6. Mbrojtja parashtron se pikat përmbushin standardin për miratimin e lejes për apel sepse: (i) pikat janë të apelueshme;⁸ (ii) kanë ndikim të ndjeshëm në kryerjen e drejtë të gjykitimit dhe rezultatin e tij;⁹ dhe (iii) zgjidhja e menjëhershme e pikave mund të avancojë thelbësisht procesin.¹⁰

7. ZPS-ja përgjigjet se pikat nuk janë të apelueshme dhe nuk kanë ndikim në përligjjen e lejes për apel.¹¹ Rrjedhimisht, ZPS-ja parashtron se Kërkesa duhet të hidhet poshtë.¹²

8. Mbrojtja kundërpërgjigjet se Trupi Gjykes, duke u bazuar vetëm në tregues që mbështesin autenticitetin dhe duke shpërfillur tregues që kundërshtojnë autenticitetin, pranoi dokumente që nuk përmbushin standardin e autenticitetit *prima facie*.¹³ Mbrojtja gjithashtu parashtron se ndërhyrja e Panelit të Gjykatës së

⁵ Kërkesa, para. 2, 12.

⁶ Kërkesa, para. 2, 13.

⁷ Kërkesa, para. 3, 16, 22.

⁸ Kërkesa, para. 12-16.

⁹ Kërkesa, para. 17-18.

¹⁰ Kërkesa, para. 19.

¹¹ Përgjigjja, para. 1-17.

¹² Përgjigjja, para. 1, 17.

¹³ Kundërpërgjigjja, para. 2, *shih gjithashtu* para. 3-4.

Apelit do të avancojë thelbësisht procesin duke vendosur një precedent të qartë lidhur me kriteret e pranueshmërisë për provat jогоjore të ardhshme.¹⁴

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse është përmbushur standardi për miratimin e lejes përcaktuar në këto dispozita. Rregulla 77(2) përcakton se:

Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

10. Trupi Gjykues përfshin përmes referimit dispozitat ligjore mbi standardin ligjor për miratimin e lejes për apel, sikurse është përcaktuar në vendime të mëparshme.¹⁵

IV. DISKUTIM

11. Fillimisht, Trupi Gjykues konstaton se treguesi i autenticitetit *prima facie* mund të ndryshojë, për shembull, në varësi të llojit dhe origjinës së dokumentit në fjalë. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues gjithashtu rikujton se gjykesit e fakteve gëzojnë kompetencë të konsiderueshme diskrecionale në marrjen e vendimit nëse një provë është e pranueshme, dhe vendimet për miratimin e lejes për apelim të

¹⁴ Kundërpërgjigja, para. 4.

¹⁵ *Shih p.sh.* F01237, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 7-8 që i referohet KSC-BC-2020-07, F00423, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues*, 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00372, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Leje për Apelim të Urdhrit F00328*, 15 tetor 2021, para. 15-17; F00484, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit F00470*, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. *Shih gjithashtu* F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim*, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

pranueshmërisë duhet të jenë përjashtim absolut.¹⁶ Këto parime pasqyrohen në vlerësimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se “ndërhyrja e apelit për vendimet në lidhje me pranimin e provave përlligjet vetëm në rrethana shumë të kufizuara.”¹⁷

A. PIKA E PARË

12. Mbrojtja parashton se Trupi Gjykses e vlerësoi autenticitetin e disa dokumenteve në bazë të treguesve të vetëm dhe konstatoi si autentik një dokument që përmbante një bllok nënshkrimesh, pavarësisht se atij i mungonin datat, nënshkrimet ose tregues të tjerë të autorësisë.¹⁸ Mbrojtja parashton se Vendimi i Kundërshtuar uli standardin për autenticitetin, pasi Trupi Gjykses konstatoi se një faktor mjafton për të vërtetuar autenticitetin e një dokumenti që paraqitet si provë. Mbrojtja argumenton se kjo nuk ka të bëjë me peshën, por pranueshmërinë e provave. Mbrojtja gjithashtu argumenton se Vendimi i Kundërshtuar përmbysi detyrimin e vërtetimit, i cili i takon ZPS-së për ta përmbushur, e jo Mbrojtjes për ta rrëzuar.¹⁹

13. ZPS-ja përgjigjet se pika e parë nuk është e apeluëshme pasi shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar dhe thjesht nuk pajtohet me të.²⁰ ZPS-ja parashton se pretendimi i Mbrojtjes në lidhje me treguesin e vetëm është i pabazuar pasi Trupi Gjykses vlerësoi disa tregues të autenticitetit *prima facie* në Vendimin e Kundërshtuar.²¹ ZPS-ja gjithashtu parashton se Trupi Gjykses qartësisht kishte parasysh detyrimin e vërtetimit të palës propozuese për të përmbushur kriteret e

¹⁶ F02241, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialit P1046* (“Vendimi mbi Lejen për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialit P1046”), 15 prill 2024, para. 10; F02157, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialeve P959 dhe P960* (“Vendimi mbi Lejen për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialeve P959 dhe P960”), 29 shkurt 2024, para. 11 dhe poshtëshënimi 26 (me referenca të mëtejshme).

¹⁷ KSC-CA-2022-01, F00114, Gjykata e Apelit, Aktgjykimi i Apelit, 2 shkurt 2023, para. 35.

¹⁸ Kërkesa, para. 12 që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 21 (SPOE00231931-00231932 dhe SPOE00231933-00231936) dhe 34.

¹⁹ Kërkesa, para. 12.

²⁰ Përgjigja, para. 3-6.

²¹ Përgjigja, para. 5.

pranueshmërisë, pasi Trupi Gjykses vlerësoi secilën prej provave materiale të propozuara dhe përshkroi faktorët e shqyrtuar.²²

14. Mbrojtja përgjigjet se, në Kërkesën e vet citoi paragrafin 34 të Vendimit të Kundërshtuar, pasi ai ilustron se si Trupi Gjykses renditi vetëm tregues në mbështetje të autenticitetit të dokumenteve dhe nuk trajtoi asnjë kundërshtim thelbësor të paraqitur nga Mbrojtja në lidhje me autenticitetin e këtyre dokumenteve. Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykses përdori të njëjtën qasje në pjesë të tjera të Vendimit të Kundërshtuar.²³

15. Trupi Gjykses vë në dukje se numri i treguesve të autenticitetit *prima facie* mund të varet nga dokumenti. Kur vlerësoi këtë kriter të pranueshmërisë, Trupi Gjykses vlerësoi disa tregues të cilët u konsideruan relevantë për vlerësimin e autenticitetit *prima facie* të dokumenteve të diskutuara, ndër të tjera, në paragrafët 23 dhe 34 të Vendimit të Kundërshtuar. Trupi Gjykses rikujton se, për provat e propozuara në paragrafin 23 të Vendimit të Kundërshtuar, Trupi Gjykses mori përsëri parasysh disa tregues relevantë të autenticitetit *prima facie* dhe në lidhje me dy dokumente të përmendura nga Mbrojtja,²⁴ Trupi Gjykses vlerësoi jo vetëm përmbajtjen e dokumentit, bllokun e nënshkrimeve, por edhe faktin se këto materiale iu sekuestruan z. Krasniqi.²⁵ Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se në lidhje me provat materiale të propozuara të vlerësuara në paragrafin 34 të Vendimit të Kundërshtuar, Trupi Gjykses mori parasysh faktin se, krahas inicialeve të UÇK-së në krye të faqeve,²⁶ shumica e dokumenteve kishin edhe një bllok nënshkrimi të SHP-së të UÇK-së dhe/ose Zëvendëskomandantit të Shtabit të Përgjithshëm dhe/ose Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, dhe/ose vulën e Shtabit të

²² Përgjigja, para. 5.

²³ Kundërpërgjigja, para. 4.

²⁴ Kërkesa, para. 12 që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 23 (SPOE00231931-00231932 dhe SPOE00231933-00231936).

²⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 23.

²⁶ *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, para. 34, poshtëshënimi 64.

Përgjithshëm.²⁷ Gjithashtu, disa dokumente kishin datë dhe ishin të nënshkruara.²⁸ Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh se disa dokumente iu sekuestruan zotit Krasniqi.²⁹ Së fundi, në mungesë të një date ose nënshkrimi, Trupi Gjykses konstatoi se autenticiteti mbështetej në faktin se ekzistenca e dokumentit konfirmohej nga dëshmi gojore.³⁰ Trupi Gjykses vë në dukje se i trajtoi kundërshtimet e Mbrojtjes në mënyrë përmbledhëse.³¹ Duke qenë se Trupi Gjykses gëzon kompetencë të konsiderueshme diskrecionale në marrjen e vendimit nëse një provë është e pranueshme, atij nuk i kërkohet të trajtojë secilin prej kundërshtimeve në qoftë se Trupi Gjykses ka identifikuar treguesit e tjerë që mbështesin autenticitetin *prima facie*.³² Në këto rrethana, sugjerimi që Trupi Gjykses uli standardin për autenticitetin dhe përmbysi detyrimin e vërtetimit është i pabazuar dhe është thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se pika e parë përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

16. Rrjedhimisht, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) në lidhje me pikën e parë. Për pasojë, kërkesa për leje për apelimin e pikës së parë hidhet poshtë.

B. PIKA E DYTË

17. Mbrojtja parashtroi se Vendimi i Kundërshtuar trajton në mënyrë joadekuate argumentin e Mbrojtjes se ZPS-ja nuk e kishte lejuar Mbrojtjen të verifikonte autenticitetin dhe vlerën provuese të dokumenteve të propozuara për t'u pranuar

²⁷ *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, para. 34, poshtëshënimi 65.

²⁸ *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, para. 34.

²⁹ *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, para. 34.

³⁰ *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, para. 34.

³¹ *Shih p.sh.* Vendimin e Kundërshtuar, para. 11-16, 25, 26.

³² Vendimi mbi Lejen për Apelin të Vendimit për Pranimin e Materialit P1046, para. 10; Vendimi mbi Lejen për Apelin të Vendimit për Pranimin e Materialeve P959 dhe P960, para. 11 dhe poshtëshënimi 26 (me referenca të mëtejshme).

si prova përmes dëshmitarëve të ZPS-së kur ZPS-ja paraqiti si prova një sasi të madhe dokumentesh të paverifikuara në fund të paraqitjes së provave prej saj.³³ Mbrojtja argumenton se për arsye të drejtësisë, një palë nuk duhet të paraqesë provat e veta në mënyrë të tillë që dëmton thelbësisht palën tjetër.³⁴

18. ZPS-ja përgjigjet se pika e dytë shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar dhe jurisprudencën përkatëse dhe thjesht nuk pajtohet me vendimin e Trupit Gjykses.³⁵ ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses ka pranuar shprehimisht detyrimin e vërtetimit të ZPS-së dhe se Mbrojtja, nëse dëshiron, mund të kundërshtojë përmbajtjen e dokumenteve, megjithëse nuk ka detyrimin ta bëjë këtë.³⁶

19. Trupi Gjykses vë në dukje se, në Vendimin e Kundërshtuar, ndër të tjera ai konstatoi se: (i) mënyra e paraqitjes së provave dhe kërkimit të pranimit në prova është kryesisht përgjegjësi e palës përkatëse; dhe (ii) fakti që autenticiteti i disa dokumenteve nuk u vërtetua dhe ato nuk u konfirmuan dhe madje në disa raste edhe u kundërshtuan nga dëshmitarë që dhanë dëshmi në këtë çështje, nuk pengon pranimin e tyre, në qoftë se përmbushen kriteret e rregullës 138.³⁷ Trupi Gjykses konstaton se, në këtë mënyrë, Vendimi i Kundërshtuar pranoi shprehimisht detyrimin e vërtetimit të ZPS-së për përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë dhe efektin që mund të kenë provat kundërshtuese mbi vlerësimin e Trupit Gjykses lidhur me peshën dhe/ose vlerën provuese të një dokumenti.

20. Mbi bazë të sa më lart, Trupi Gjykses është i mendimit se pika e dytë shtrembëron konstatimet e Trupit Gjykses dhe thjesht përbën mospajtim me to.

³³ Kërkesa, para. 13-14.

³⁴ Kërkesa, para. 13.

³⁵ Përgjigjja, para. 8, 11.

³⁶ Përgjigjja, para. 9, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 29, 37.

³⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 13.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se pika e dytë përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

21. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë të shqyrtohen kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) lidhur me pikën e dytë. Për pasojë, hidhet poshtë kërkesa për miratimin e lejes për apel për pikën e dytë.

C. PIKA E TRETË

22. Pika e tretë kundërshton konstatimin e Vendimit të Kundërshtuar se vlera provuese e materialeve nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre, “duke marrë parasysh në veçanti se Mbrojtja do të ketë mundësi të bëjë parashtrime në lidhje me peshën dhe vlerën provuese të këtyre materialeve dhe nëse dëshiron, mund të kundërshtojë përmbajtjen e tyre përmes paraqitjes së provave, megjithëse nuk ka detyrimin ta bëjë këtë.”³⁸ Mbrojtja parashtron se Vendimi i Kundërshtuar mbështetet në të njëjtin arsyetim sa i takon efektit dëmtues të të gjitha dokumenteve dhe se një qasje e tillë përbën gabim themelor.³⁹ Mbrojtja argumenton se duke konstatuar se efekti dëmtues mund të ndreqet përmes paraqitjes së provave të Mbrojtjes, Trupi Gjykses e përmbys detyrimin e vërtetimit dhe i kërkon Mbrojtjes të rrëzojë pretendimet, në vend që t’i kërkojë ZPS-së që t’i vërtetojë ato.⁴⁰

23. ZPS-ja përgjigjet se pika e tretë shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar dhe jurisprudencën përkatëse dhe thjesht nuk pajtohet me konstatimet e Trupit Gjykses. ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses ka pranuar shprehimisht detyrimin e vërtetimit të ZPS-së dhe se Mbrojtja, nëse dëshiron mund të kundërshtojë përmbajtjen e dokumenteve, megjithëse nuk ka detyrimin ta bëjë këtë.⁴¹ ZPS-ja

³⁸ Kërkesa, para. 15, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 29, 37, 49, 68, 76, 94, 109, 123, 133.

³⁹ Kërkesa, para. 15.

⁴⁰ Kërkesa, para. 15.

⁴¹ Përgjigja, para. 9, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 29, 37.

gjithashtu argumenton se Trupi Gjykses nuk konstatoi asnjëherë se efekti dëmtues mund “të ndreqet” përmes paraqitjes së provave.⁴² ZPS-ja argumenton më tej se pretendimi i Mbrojtjes se Trupi Gjykses bëri “gabim themelor” kur u mbështet në të njëjtin arsyetim sa i takon efektit dëmtues është njësoj i pabazuar dhe ai shpërfill faktin se, përpara se të vlerësonte vlerën provuese të provave materiale të propozuara dhe t’i peshonte ato kundrejt çdo efekti dëmtues, Trupi Gjykses bëri konstatime të gjera individuale lidhur me relevancën dhe autenticitetin e provave materiale të propozuara.⁴³

24. Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se lidhur me pranueshmërinë e provave zbatohen të njëjtat kritere gjatë të gjithë procesit, si në fillim apo në fund të tij. Trupi Gjykses vë në dukje më tej se qëllimi kryesor i listës së provave materiale që një palë duhet të dorëzojë para fillimit të paraqitjes së provave prej saj është kryesisht të njoftojë palën kundërshtare (dhe Trupin Gjykses) për provat ku ajo synon të mbështetet si pjesë e paraqitjes së provave të saj. Rrjedhimisht, Mbrojtja ishte në dijeni të qëllimit të ZPS-së për të përdorur dhe për t’u mbështetur në secilin prej dokumenteve që nga fillimi i këtij procesi.

25. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton konstatimin e vet në Vendimin e Kundërshtuar se vlera provuese e materialeve të paraqitura për pranim nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre ndaj të akuzuarve, duke theksuar në veçanti faktin se Mbrojtja do të ketë mundësi të bëjë parashtrime në lidhje me peshën dhe vlerën provuese të këtyre materialeve dhe, nëse dëshiron, mund të kundërshtojë përmbajtjen e tyre përmes paraqitjes së provave, megjithëse nuk ka detyrim ta bëjë këtë. Kur bëri këto konstatime, Trupi Gjykses u bind se në këtë fazë dhe në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes, vlera provuese e dokumenteve të paraqitura nuk zhbëhej prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarve.⁴⁴ Asgjë në

⁴² Përgjigjja, para. 9, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 29, 37.

⁴³ Përgjigjja, para. 10.

⁴⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 29, 37, 49, 68, 76, 94, 109, 123, 133.

Vendimin e Kundërshtuar nuk supozonte ose kërkonte që Mbrojtja të bënte parashtrime në lidhje me peshën dhe vlerën provuese të këtyre materialeve ose të kundërshtonte përmbajtjen e tyre përmes paraqitjes së provave. Siç u përmend më lart, Trupi Gjykses theksoi qartazi faktin se Mbrojtja nuk ka asnjë detyrim për këtë aspekt. Rrjedhimisht, sugjerimi se Vendimi i Kundërshtuar e përmbysi detyrimin e vërtetimit është i pabazuar dhe përbën shtrembërim të Vendimit të Kundërshtuar.

26. Trupi Gjykses rikujton se vendimet në lidhje me pranimin e provave janë vendime diskrecionale në lidhje me të cilat duhet t'i japë përparësi Trupit Gjykses.⁴⁵ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses kujton gjithashtu se, përpara se të vlerësonte vlerën provuese të provave të paraqitura dhe ta peshonte atë kundrejt efektit dëmtues, Trupi Gjykses bëri konstatime të gjera mbi relevancën dhe autenticitetin e dokumenteve të paraqitura, duke bërë kështu një vlerësim individual në lidhje me secilën provë materiale të propozuar.⁴⁶

27. Mbi bazë të sa më lart, Trupi Gjykses është i mendimit se pika e tretë shtrembëron konstatimet e Trupit Gjykses dhe thjesht përbën mospajtim me to. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se pika e tretë përbën një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

28. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë të shqyrtohen kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2) lidhur me pikën e tretë. Për pasojë, hidhet poshtë kërkesa për miratimin e lejes për apel për pikën e tretë.

⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit, para. 34.

⁴⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 19-131.

V. KLASIFIKIMI

29. Trupi Gjykses në dukje se Kërkesa është dorëzuar si konfidenciale. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen që të kërkojë riklasifikimin ose të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kërkesës deri të premtën, 27 qershor 2025.

30. Duke vënë në dukje se Përgjigjja dhe Kundërpërgjigjja janë dorëzuar si konfidenciale në përputhje me rregullën 82(4) dhe se ZPS-ja dhe Mbrojtja kërkojnë riklasifikimin e tyre si publike,⁴⁷ Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative të riklasifikojë Përgjigjen dhe Kundërpërgjigjen si publike.

⁴⁷ Përgjigjja, para. 16. Kundërpërgjigjja, para. 5.

VI. VENDIM

31. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **HEDH POSHTË** kërkesën për leje për apelimin e pikave;
- b) **UDHËZON** Zyrën Administrative të riklasifikojë Përgjigjen dhe Kundërpërgjigjen si publike; dhe
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen që të kërkojë riklasifikimin ose të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kërkesës deri të premtën, 27 qershor 2025.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 20 qershor 2025

Në Hagë, Holandë.